



Shaip Kamberi ka lindur më 1 tetor 1964, në Tërnoc të Madh të komunës së Bujanocit. Me profesion është jurist i diplomuar.

Për herë të parë në funksionin e kryetarit të komunës së Bujanocit është zgjedhur në vitin 2008.

Pas mbarimit të mandatit të kryetarit të komunës, në vitin 2012, Kamberi nga pozita e lartë në Partinë për Veprim Demokratik ka përcjellur zhvillimet politike në nivelin lokal.

Nga viti 2014 deri vitin 2016, ka qenë në pozitën e deputetit popullor në Kuvendin Kombëtar të Republikës së Serbisë.

Në vitin 2016, Shaip Kamberi për herë të dytë është zgjedhur në vendin e kryetarit të komunës së Bujanocit, ndërsa edhe më tutje është në funksionin e nënkryetarit të Partisë për Veprim Demokratik.

Kamberi është themelues dhe kryetar i Këshillit për të Drejtat e Njeriut.

Shaip Kamberi është i martuar dhe ka dy fëmijë.